



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



**DREJTORIA PËR ARSIM**

Nr.13/60  
Datë:31.01.2019  
Dragash

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-032, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 01B/4583 të datës:25.10.201, Vendimeve të MASHT, Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, shpall:

**OFERTË PËR TRAJNERË TË FUSHAVE TË KURRIKULËS SË RE**

1. Trajner të fushës së Gjuhët dhe Komunikimi - 1 (një) trajnerë
2. Trajner të fushës së Matematikës – 1 (një) trajnerë
3. Trajner të fushës së Shkencave të Natyrës - 1 (një) trajnerë
4. Trajner të fushës Shoqëria dhe Mjedisi - 1 (një) trajnerë
5. Trajner të fushës së Arsimit fillor dhe klasës përgatitore - 1 (një) trajnerë
6. Trajner të fushës së Arteve - 1 (një) trajnerë
7. Trajner të fushës së Edukatës fizike Sportit dhe Shëndetit - 1 (një) trajnerë
8. Trajner të fushës së Jeta dhe Puna - 1 (një) trajnerë
- 9. Trajner për komunitetin boshnjak - nga 1 (një) trajnerë për secilën fushë të Kurrikulës**

**Kushtet dhe kriteret për trajner të Kurrikulës së Re të Kosovës në komunën e Prizrenit:**

1. Të jetë mësimdhënës i rregullt në shkollat publike të Komunës së Dragashit;
2. Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në mësimdhënie/arsim;
3. Të jetë në lëmin/fushën përkatëse për të cilat është i thirrur për mbajtjen e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i;
4. Të jenë të certifikuar si trajnerë ose si pjesëmarrës i trajnimit të zbatimit në praktik të Kurrikulës së Re sipas programeve të akredituara nga MASHT-i;

5. Të njohë mirë Kurrikulën e Re të Kosovës, me përparësi për ata të cilët kanë qenë në zbatim të KK-së së Re;
6. Të njoh mirë përdorimin e kompjuterit;
7. Të jetë person kreativ dhe për secilin aktivitet trajnues dhe mentorues të raportoj me kohë;
8. Të ketë licencë të mësimdhënies (e preferuar);
9. Të respektojë marrëveshjen me përpikëri për trajnimet në mes të MASHT-it dhe DKA-së;

Si më sipër Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, bazuar në legjislacionin në fuqi, do të marrë vendim për angazhimin e trajnerëve në trajnime sipas fazave që organizon në bashkëpunim DZHPM- në MASHT me DKA -në Dragash, ku edhe kontratat e angazhimeve nënshkruhen po nga DZHPM në MASHT.

**Të interesuarit do të paraqesin këto dokumente:**

- Kopjen e diplomës nga kualifikimi (e vërtetuar);
- Licencën e mësimdhënësit;
- Vërtetim mbi përvojën e punës në arsim;
- CV personale;
- Portfolio dhe orë model e mësimdhënësit në zbatim të KK-së në praktik;
- Certifikata të trajnimeve të akredituara;
- Një referencë nga drejtori i shkollës bazuar në vlerësimin e tij/saj;
- Kandidatët e interesuar do të nënshkruhen një procesi të vlerësimit;

Oferta do të jetë e hapur 15 ditë nga shpallja në ueb faqe të komunës dhe dokumentet dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Dragash.



Drejtori i DKA-së  
MSc. Vloran Cenaj